

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË “AICA
IMOBILIARE” SH.P.K.**

Sot më datë 17.10.2022, ortaku i vetëm i Shoqërisë “AICA IMOBILIARE” sh.p.k., person juridik shqiptar, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) M12424014E (më tej referuar si “Shoqëria”), Z. Armand Hoxha, i cili zotëron 1 (një) kuotë që përbën 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, mori në shqyrtim çështjet si më poshtë:

Rendi i ditës:

- Miratimi i raportit të shndërrimit të Shoqërisë, nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare me ofertë private;
- Shndërrimi i Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në shoqëri aksionare me ofertë private;
- Miratimi i statutit të ri të Shoqërisë.


Ortaku i vetëm, pas shqyrtimit të këtyre çështjeve,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të shndërrimit të Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare me ofertë private, datë 17.10.2022;
2. Miratimin e shndërrimit të Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në shoqëri aksionare me ofertë private, bazuar në raportin e shndërrimit;
3. Miratimin e statutit të ri të Shoqërisë;

Ortak i Vetëm

Z. Armand Hoxha



**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË
SHOQËRISË “AICA IMOBILIARE” SH.P.K.**

Sot më datë 17.10.2022, ora 08:00 u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “AICA IMOBILIARE” sh.p.k, me NUIS M12424014E (“**Shoqëria**”), në të cilën mori pjesë ortaku i vetëm i Shoqërisë, Z. Armand Hoxha, zotërues i 1 (një) kuote që përbën 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Ortaku i vetëm Shoqërisë shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, si më poshtë:


- Miratimi i raportit të shndërrimit të Shoqërisë, nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare me ofertë private;
- Shndërrimi i Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në shoqëri aksionare me ofertë private;
- Miratimi i statutit të ri të Shoqërisë.

Ortaku i vetëm, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, si dhe statutit të Shoqërisë, vendosi:

- Miratimin e raportit të shndërrimit të Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare me ofertë private, datë 17.10.2022;
- Miratimin e shndërrimit të Shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në shoqëri aksionare me ofertë private, në bazë të raportit të shndërrimit;
- Miratimin e statutit të ri të Shoqërisë;

Ortak i Vetëm

Z. Armand Hoxha



Tiranë, më 17.10.2022

RAPORT SHNDËRRIMI

- LËNDA:** Raport shndërrimi për shoqërinë AICA IMOBILIARE sh.p.k nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare me ofertë private
- NGA:** Armand Hoxha, lindur në Radë, Durrës, më 24.03.1974, identifikuar me letërnjoftim me nr.personal H40324011R, në rolin e administratorit të Shoqërisë AICA IMOBILIARE sh.p.k
- BAZA LIGJORE:** Nenet 228-229 të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Neni 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar; Neni 27 të Statutit të Shoqërisë
- DREJTUAR:** Shoqërisë AICA IMOBILIARE sh.p.k (në vijim “**Shoqëria**”), me NUIS M12424014E, me adresë në Tiranë, Vorë, Muçaj, ZK.2726, nr.pasurie 142/46, vol.9, fq.157

I. Hyrje

Nëpërmjet këtij raporti shndërrimi për shoqërinë AICA IMOBILIARE sh.p.k nga forma e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare me ofertë private (në vijim “**Raporti**”), do të parashtrohen bazat ekonomike dhe ligjore për pasqyrimin e vullnetit të ortakut të vetëm dhe njëkohësisht administratorit të Shoqërisë (ekstrakti i thjeshtë i së cilës i bashkëngjitet Raportit si Shtojca 1), Z. Armand Hoxha, për shndërrimin e Shoqërisë nga forma aktuale si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në shoqëri aksionare, në përputhje të plotë me ligjin nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vijim “**Ligji Tregtar**”).

II. Baza ekonomike e riorganizimit

Interesi në lidhje me shndërrimin e Shoqërisë nga forma e sh.p.k-së (shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar) në formën e sh.a-së (shoqërisë aksionare) me ofertë private, lidhet me zhvillimin e dinamizmit tregtar të Shoqërisë, e cila kryen veprimtari në fushën e ndërtimit, zhvillimit, shfrytëzimit të hoteleve dhe zonave turistike dhe çdo lloj veprimtarie të ligjshme që konsiderohet fitimprurëse për Shoqërinë.

Dinamizmit tregtar të Shoqërisë i përshtatet më tepër forma e shoqërisë aksionare në kushtet kur në Shoqëri mund të hyjnë aksionarë të tjerë dhe kjo formë shoqërie mundëson ekzistencën e aksioneve me përparësi, me të cilat mund të pajisen aksionarë të ndryshëm, në varësi të interesave të lindura kohë pas kohe. Në datën e këtij Raporti, Shoqërisë i intereson të emetojë krahas aksioneve të zakonshme, edhe aksione me përparësi me të drejtë vote, përparësitë e të cilave planifikohen të jenë:

- (a) të drejta vote në masën 5% (pesë për qind) në Asamblenë e Përgjithshme, që ndahet proporcionalisht mes aksioneve me përparësi;
- (b) të drejtën e dividendit në masën 50% (pesëdhjetë për qind) të fitimit të Shoqërisë, të ndarë proporcionalisht mes aksioneve me përparësi;

- (c) të drejtën për të tërhequr dividend pavarësisht nëse e drejta për të tërhequr dividend ushtrohet ose jo për aksionet e zakonshme.

Shoqëritë aksionare gjithashtu kanë një kapital të regjistruar minimal në një masë më të lartë se shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe rezerva ligjore të detyrueshme të parashikuara në ligj, gjë e cila ndihmon Shoqërinë të garantojë më mirë detyrimet e saj kundrejt kreditorëve, të cilët do të ndihen më komodë në hyrjen e marrëdhënieve të reja me Shoqërinë.

Në datën e këtij Raporti, Shoqëria ka një kapital të regjistruar prej 4,722,900 lekë (katër milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë e nëntëqind lekë), të përfaqësuar në një kuotë të vetme. Shndërrimi i Shoqërisë në shoqëri aksionare me ofertë private kërkon një kapital të regjistruar minimal të paktën prej 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë, masë të cilën kapitali aktual i Shoqërisë e arrin dhe e tejkalon.

Kapitali i regjistruar prej 4,722,900 lekë (katër milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë e nëntëqind lekë), do të jetë i ndarë në 42,731 (dyzet e dymijë e shtatëqind e tridhjetë e një) aksione të zakonshme si dhe 2,249 (dymijë e dyqind e dyzet e nëntë) aksione me përparësi, secili prej të cilëve do të ketë një vlerë nominale prej 105 (njëqind e pesë) lekë. Në datën kur do të realizohet shndërrimi, aksionari i vetëm i Shoqërisë do të zotërojë 100% (njëqind për qind) të aksioneve.

III. Baza ligjore e riorganizimit

Ky Raport si dhe tërë procedura e shndërrimit të Shoqërisë, është e parashikuar në përputhje të plotë me:

- (a) Nenet 228-229 të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar
- (b) Nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar (në vijim “**Ligji për Regjistrimin e Biznesit**”); si dhe
- (c) Nenin 27 të Statutit të Shoqërisë.

Shndërrimi i Shoqërisë nga forma e sh.p.k-së në atë të sh.a-së parashikohet në paragrafin e parë të nenit 228 të Ligjit Tregtar, ku thuhet se:

“Një shoqëri tregtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit, si më poshtë: a) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri aksionare dhe anasjelltas;”

Njëkohësisht, në mënyrë të ngjashme, Statuti aktual i Shoqërisë parashikon në nenin 27 të tij se:

“Një shoqëri tregtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit, si më poshtë: a. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri aksionare dhe anasjelltas.”

Dispozitat e lartpërmendura i njohin të drejtën Asamblesë së Përgjithshme të kryejë shndërrimin. Për të finalizuar këtë procedurë, është gjithashtu e nevojshme mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme sipas procedurave të nenit 229 të Ligjit Tregtar. Duke qenë se në datën e këtij Raporti Shoqëria është me ortak të vetëm, nuk janë të nevojshme të respektohen procedurat e hollësishme parashikuara nga Ligji Tregtar lidhur me njoftimin e ortakëve.

Kur ortakut i vetëm të shqyrtojë raportin dhe të marrë vendim mbi riorganizimin e Shoqërisë, është e nevojshme që në vendimin përkatës të miratohet një statut i ri për Shoqërinë, i përshtatshëm për formën e re të Shoqërisë si shoqëri aksionare. Modeli i këtij statuti të sugjeruar i bashkëlidhet këtij raportit si Shtojca 2.

Modeli i sugjeruar për shoqërinë aksionare nga ana jonë (siç edhe paraqitet në statutin e sugjeruar) është ai me dy nivele drejtimi. Sugjerojmë që Këshilli Mbikëqyrës të përbëhet nga 3 (tri) anëtarë, trup i cili në mandatin e tij të parë të përbëhet nga:

- (a) Z. Armand Hoxha, i datëlindjes 24.03.1974, lindur në Radë, Durrës, Shqipëri mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H40324011R;
- (b) Z. Fatmir Kazazi, i datëlindjes 21.09.1958, lindur në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal F80921046O;
- (c) Znj. Ilda Çela, e datëlindjes 03.04.1995, lindur në Kavajë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J55403053S.

Me kryerjen e rregullt të procesit të vendimmarrjes nga ortakut i vetëm, duhen kryer procedurat e regjistrimit në QKB të akteve me të cilat është realizuar shndërrimi. Për këtë, neni 229, pika 7 e Ligjit Tregtar parashikon se:

“7. Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me vendimin e shndërrimit, procesverbalin e asamblesë së përgjithshme për vendimin e shndërrimit, dokumentet e vendimit të aksionarëve të veçantë dhe të aksionarëve, të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në mbledhjen e asamblesë. Sipas rastit, informacioni i lartpërmendur vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë.”

Gjithashtu Ligji për Regjistrimin e Biznesit, në nenin 43, pika 3, parashikohet se:

“3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë: [...]

ç) aktet e prishjes, mbylljes apo shpërndarjes, aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. [...]”

Me regjistrimin e akteve përkatëse siç parashikojnë ligjet në fjalë, Shoqëria do të shndërrohet në shoqëri aksionare, duke u ndryshuar emri i saj nga “AICA IMOBILIARE sh.p.k” në “AICA IMOBILIARE sh.a”. Gjithashtu, nga momenti i regjistrimit, Shoqëria do të funksionojë në bazë të statutit të ri të miratuar.

Ligji Tregtar gjithashtu bën të qarta dhe pasojat që do të sillte një shndërrim i tillë, si më poshtë:

“8. Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që:

a) shoqëria që shndërrohet, të vazhdojë të ekzistojë në formën ligjore, të përcaktuar në vendimin e shndërrimit;

b) aksionarët/ortakët e shoqërisë që shndërrohet, të marrin pjesë në shoqëri, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, për formën e re të shoqërisë;

c) të drejtat e personave të tretë për aksionet e shoqërisë që transformohet, të vazhdojnë të zbatohen edhe për aksionet e shoqërisë së shndërruar.”

IV. Efekti i shndërrimit të punëmarrësit të Shoqërisë

Pavarësisht ndryshimit të formës së Shoqërisë, nuk do të ketë efekte të veçanta të punëmarrësit aktualë. Secili punëmarrës i Shoqërisë do të vazhdojë marrëdhënien e varur të punës bazuar në kontratat e punës siç janë në fuqi dhe në bazë të legjislacionit përkatës.

Shoqëria e shndërruar garanton se do të marrë përsipër çdo detyrim lidhur me punëmarrësit siç i ka marrë përsipër në formën kur ka qenë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

V. Konkluzione

Në bazë të shpjegimeve dhe sugjerimeve të parashtruara më lart në këtë Raport, sugjerojmë që ortaku i vetëm i Shoqërisë të vendosë:

- (a) Miratimin e këtij Raporti;
- (b) Miratimin e Statutit të ri të Shoqërisë sipas modelit bashkëlidhur këtij Raporti si Shtojca 2; dhe
- (c) Miratimin e Vendimit të Ortakut të Vetëm sipas modelit bashkëlidhur këtij Raporti si Shtojca 3.

ADMINISTRATORI

Armand Hoxha

